

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në datën 21.11.2022 i kam paraqitur Kuvendit të Republikës së Shqipërisë një amendament për disa ndryshime në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”. Në fakt, si nënë, si arsimtare, por edhe si anëtare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas konsultimit të gjerë edhe me kolegët e komisionit, por dhe me faktorë të ndryshëm të shoqërisë civile kam marrë iniciativën sot të propozoj ndryshimin në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”.

Në nenin 1, në tabelën nr. 2 “Numri i punonjësve 2023, sipas institucioneve”, zëri “Ministria e Arsimit dhe Sportit”, numri “31 005” të zëvendësohet me numrin “31 105”.

Neni 2: “Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit”. Ky ndryshim lidhet me një nevojë të domosdoshme për rritjen e numrit të mësuesve ndihmës, ndërkohë që kemi një rritje të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me aftësi e nevoja të ndryshme.

Për t’iu përgjigjur këtyre nevojave gjithnjë e në rritje për mësues ndihmës, amendamenti kërkon që të ketë qasje reale ndaj edukimit gjithëpërfshirës dhe integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit parauniversitar, duke nisur prej edukimit parashkollor deri në arsimin e mesëm dhe në mënyrë ideale edhe në arsimin e lartë. Mësuesit ndihmës, në ndryshim nga mësuesit e klasës, duhet të kenë kualifikimet e nevojshme, të cilat lidhen ngushtësisht me punën e tyre specifike. Nisur nga kjo nevojë mësuesi ndihmës duhet të punojë me jo më shumë se 2 nxënës me aftësi të kufizuara dhe me nevoja ndryshe. Raportimet e mediave vënë theksin se në zonat urbane, por akoma më shumë në zonat rurale, ka një mangësi të mësuesve ndihmës.

Për ta bërë edhe më pak të favorshme situatën, jam vënë në dijeni nga burime të ndryshme në terren se këta mësues kanë mungesa të theksuara sa i përket trajnimit të tyre profesional. Për ta mbështetur argumentin tim jam bazuar edhe në dhënat e një studimi të UNICEFit të vitit 2018. Këto të dhëna

tregojnë se prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk janë të kënaqur: 1. me ecurinë e fëmijëve në shkollë, 19,4%; 2. me nivelin e përshtatjes së mësimdhënies me nevojat dhe zhvillimin e fëmijës, 13,3%; 3. me nivelin e respektit të shfaqur nga stafi arsimor 6,3%. Një pjesë e këtyre prindërve kanë ankesa për mungesën e mësuesve ndihmës, largimin e mësuesve ndihmës në vijim të vitit shkollor dhe pamundësinë e sistemit arsimor për t'i zëvendësuar këto mungesa në kohë, duke mos lejuar dëmtimin e asnjë procesi.

Nisur edhe nga ky shqetësim legjitim i prindërve është e domosdoshme të rritet numri i mësuesve ndihmës. Çdo mangësi e evidentuar në këtë proces cenon integritetin njerëzor dhe në thelb mbetet cenim i të drejtave të njeriut. Jemi të vetëdijshëm që pandemia globale na vendosi në një terren mjaft sfidues, i cili duhet thënë se pati pasoja të mëdha edhe te fëmijët me aftësi të kufizuara. Për arsye ekonomike e sociale ata humbën komunikimin me mësuesit e tyre. Ky komunikim, edhe në rastet kur kryhej, kishte pengesa, të cilat sollën një ndërprerje dhe pamjaftueshmëri të procesit mësimor. Me kthimin në shkollë një pjesë e nxënësve nuk i gjetën më mësuesit e tyre për të funksionuar si rregullatorë dhe për të krijuar qëndrueshmëri.

Ndaj, edhe për të qenë më të gatshëm në raste nevojë, e kemi parë të arsyeshme rritjen e numrit të mësuesve ndihmës. Ne, si ligjvënës, e kemi për detyrë, mes të tjerash, të përmirësojmë përmes nismave ligjore dhe qasjeve tona proaktive jetën e shoqërisë, për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, pa asnjë dallim. Diversiteti është norma e një shoqërie gjithëpërfshirëse, dhe sot duhet të tregojmë që jemi këtu për të bërë realitet detyrimin kushtetues që çdo fëmijë me aftësi të kufizuar dhe me nevoja ndryshe ka të drejtë të përfitojë arsim cilësor, ka nevojë për vëmendje të veçantë dhe për një punë të specializuar dhe të mirorganizuar.

Shkolla dhe mësuesit gjithmonë duhet t'i mbajnë të përfshirë këta fëmijë në jetën shkollore, por edhe në atë jashtëshkollore, me qëllimin që të kemi një integrim sa më të mirë dhe të plotë në shoqëri. Për këto arsye, ne mendojmë se do të ishte i nevojshëm ky amendim, duke dhënë edhe një sinjal pozitiv, se ne jemi së bashku me prindërit e këtyre fëmijëve, që ata të mos e ndiejnë veten të veçuar dhe në pamundësi reale për të marrë një arsim cilësor, pavarësisht vendit ku jetojnë apo statusit të tyre social dhe ekonomik. Pavarësisht ndasive politike, do të ishte në nderin e këtij parlamenti ta votonim këtë amendament. Faleminderit!